

VENDIM
Nr. 582, datë 3.8.2016

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES, PËR SHOQËRINË
“QENDRA SPORTIVE “KUQ E ZI””, SHA, TË SIPËRFAQES SË PËRGJITHSHME PREJ
2800 m², PËR T’U PËRDORUR PËR NDËRTIMIN E OBJEKTIT “KOMPLEKSI I RI I
STADIUMIT KOMBËTAR” DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 143, DATË
18.1.2012, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE
(PJESA E PARË + PJESA E DYTË) TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE,
SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË
BASHKISË TIRANË, TË QARKUT TË TIRANËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 3, 10, 12 e 13, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme dhe të ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, për shoqërinë “Qendra sportive “Kuç e Zi””, sh.a., të sipërfaqeve 2 711 (dy mijë e shtatëqind e njëmbëdhjetë) m², pjesë e pasurisë 7/6, dhe të sipërfaqes 89 (tetëdhjetë e nëntë) m², pjesë e pasurisë 6/24, në zonën kadastrale 8160, me sipërfaqe të përgjithshme prej 2 800 (dy mijë e tetëqind) m² truall, sipas planrilevimit, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për t’u përdorur për ndërtimin e objektit “Kompleksi i ri i Stadiumit Kombëtar”.

2. Prona e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, të hiqet nga lista e inventarit të pronave shtetërore, miratuar me vendimin nr. 143, datë 18.1.2012, të Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Ministria e Punëve të Brendshme, Bashkia e Tiranës dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

PLAN RILEVIMI

PERGATITI

Emri, Inga Zila B. JULI
 Inga Zila B. JULI
 Punime (300) 0479
 Licenca Nr. 0032780
 Cel 0682032780
 TIRANE - ALBANIA
 data e pergatitjes 01.08.2016

forma 1/1000

IDENTIFIKIMI I PASURISE

ZONA KADASTRALE 8160
 Nr i pasurise 7/6-II, 6/24-II, Vol., Fq.
 Indeksi i Hartes TR-S12
 Skala 1/500 Superfaqe 2711 m²
 Superfaqe 89 m²
 Adresa e Pasurise Rrethi Tirane
 Ith. Sporturi kombetar "Qemal Stafa"
 P/G: Sh K Ap
 PRONARI F SH F QENDRA SPORTIVE "KUQ E ZI"



